



International Maarif Schools of Kosova
Përfaqësuar nga Avokati z. Ahmet TAHIRI
Rr. Sylejman Vokshi 3/6
Prishtinë

Ankesa Nr. 2018/54
Ref:1808/875/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2018/54–International Maarif Schools of Kosova (Palë Ankuese) kundër KTV-së

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/3, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 24 prill 2018 ka pranuar një ankesë nga International Maarif Schools of Kosova ndaj KTV-së, për kronikën e transmetuar në lajmet qëndrore të orës 19:00, të transmetuar me datën 18 prill 2018, përmes së cilës International Maarif Schools of Kosova pretendon se KTV përmes kësaj kronike ka dëmtuar reputacionin dhe imazhin e shkollës, duke raportuar në kronikën se shkollat “Maarif” janë jashtë kontrollit të Ministrisë së Arsimit, duke mos e respektuar udhëzimin administrativ të MASHT-it lidhur me respektimin e kodit të veshjes, respektivisht bartjes së shamisë. International Maarif Schools of Kosova këtë kronikë e konsideron si tendencioze, të pavërtetë dhe me elemente shpifjeje dhe kërkon nga KTV të bëhet korrigjimi i lajmit si dhe kërkim falje në të njëjtën format si të lajmeve që është transmetuar.
3. KPM me datën 2 maj 2018 nëpërmes një shkrese e ka njoftuar KTV-n për ankesën e pranuar nga International Maarif Schools of Kosova dhe ka kërkuar sqarim lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM me datën 4 maj 2018 ka pranuar një përgjigje nga KTV, përmes së cilës i mohon si të paqëndrueshme pretendimet e International Maarif Schools of Kosova.
5. KPM ka analizuar ankesën e International Maarif Schools of Kosova, përgjigjen e KTV-së dhe bazuar në raportin e monitorimit të datës 29 maj 2018 ka gjetur se KTV nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
6. KPM me datë 11 qershor 2018 përmes emailit ka kërkuar nga International Maarif Schools of Kosova që ta shfrytëzojë të drejtën e reagimit dhe që brenda afatit dy (2) ditë nga data e

pranimi të emailit, të na njoftojë në lidhje me shfrytëzimin e të drejtës për reagim ose heqjen dorë nga kjo e drejtë.

7. Edhe përkundër faktit se International Maarif Schools of Kosova e ka konfirmuar pranimin e kërkesës së KPM-së për ta shfrytëzuar të drejtën e reagimit, nuk ka njoftuar se e ka shfrytëzuar të drejtën për reagim në KTV.

Analiza Ligjore

8. Komisioni i KPM-së bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se KTV nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
9. Komisioni i KPM-së pretendimet e International Maarif Schools of Kosova i ka trajtuar në bazë të neneve të cekura në ankesë, në kuptimin e nenit 5, paragrafi 3 dhe nenit 6, paragrafi 2 dhe 7 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 5, paragrafi 3, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton:

“OSHM-të gjatë transmetimit të përmbajtjes nuk do të lejojnë përdorimin e shprehjeve gjuhësore denigruese, me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi në bazë të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, gjendjes martesore, moshës apo paastësisë fizike ose mendore.”

10. KPM gjatë monitorimit ka gjetur se International Maarif Schools of Kosova duke u referuar në këtë nen pretendon se kronika përbën elemente të gjuhës denigruese, mirëpo bazuar në raportin e monitorimit është gjetur se KTV në kronikën e transmetuar nuk ka përdorur gjuhë të tillë pasi që nuk janë gjetur elemente të gjuhës denigruese gjatë transmetimit të kronikës, përveç se qëllimi ka qenë informimi i publikit rreth shkollës se si funksionin dhe planprogramit të saj.

Neni 6 paragrafi 2 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton :

“OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërtshënive politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ.”

11. Komisioni i KPM-së ka gjetur se kronika e transmetuar ka qenë mirë e balancuar sepse KTV për këtë rast ka kontaktuar edhe me Ministrinë e Arsimit, e cila nuk ka dhënë përgjigje konkrete përpos se shkolla International Maarif Schools of Kosova është shkollë e licencuar në vitin 2017 dhe programi i saj është i licencuar nga Ministria e Arsimit.

Neni 6, paragrafi 7 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton:

“OSHM-të duhet të ofrojnë prezantim të perspektivave të ndryshme në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Në qoftë se njëra palë refuzon që të ofrojë pikëpamjen e saj, publiku duhet të informohet për këtë refuzim.”

12. Komisioni i KPM-së ka gjetur edhe se kronika nuk është gjetur në shkelje pasi që KTV ka kontaktuar disa herë përmes telefonit me zyrtarët e International Maarif Schools of Kosova

lidhur me kronikën e transmetuar, mirëpo njëri nga administratorët e shkollës z. Erdogan Shporta i ka sugjeruar gazetarët që të kthehen dhe se shkollën mund ta vizitojnë vetëm kur t'i thërrasin.

13. Komisioni i KPM-së gjithashtu ka gjetur se KTV ka vepruar edhe në pajtim me nenin 5 paragrafi 3 dhe nenin 6 paragrafi 2 dhe 7 pasi që gazetari i ka ofruar mundësinë të gjitha palëve për ofrimin e qëndrimit të tyre përmes intervistave dhe nuk është vërejtur asnjë anim ose favorizim gjatë transmetimit të kronikës.
14. Komisioni i KPM-së ka analizuar edhe përgjigjen e KTV-së e cila ofron sqarime të mjaftueshme dhe të hollësishme, të cilat u vërtetuan edhe me monitorimin e bërë nga Zyra Ekzekutive.
15. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjeturat e monitorimit ka gjetur se KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 gjatë transmetimit të kronikës me titull "Maarif jashtë kontrollit të MASHT" të transmetuar në lajmet qendrore.
16. Prandaj, Komisioni i KPM-së duke u bazuar në faktet e lartpërmendura gjen se KTV kundër të cilës është ankuar International Maarif Schools of Kosova është në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KPM-2016/03.

Vendimi

17. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se KTV ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03.
18. Ankesa e International Maarif Schools of Kosova përmes së cilës pretendohet se KTV i ka dëmtuar reputacionin dhe imazhin e shkollës, refuzohet si e pabazuar.

E drejta për Ankesë

19. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
20. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim


Muja FERATI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



09.08.2019

Datë